



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

LOCAL GOVERNANCE
PROGRAM IN ALBANIA

SUCCESS STORY

Panairi EXPO-REAL – Një tjetër mundësi për Bashkinë e Korçës për të tërhequr investitorë

Programi i USAID-it për Qeverisjen Vendore financoi një studim urbanistik për rinovimin dhe zgjerimin e kompleksit sportiv të qytetit.



Niko Peleshi, Kryetar i Bashkisë së Korçës, dhe Rajmonda Nase, përfaqësuese e GTZ-së, diskutojnë për opinionet e vizitorëve të panairit Expo Real në lidhje me mënyrat e përmirësimit të kompleksit sportiv të qytetit.

Çdo vit, panairi EXPO-REAL në Mynih të Gjermanisë mbledh biznese, investitorë të mundshëm si dhe qeveritë qendrore dhe vendore nga e gjithë bota. Në vitin 2007, Panairi EXPO-REAL bashkoi 1823 ekspozita nga 43 vende dhe 23,800 vizitorë nga 77 shtete të ndryshme. Bashkia e Korçës u përfaqësua në panairin e vitit 2007 me një projekt për ngritjen e një universiteti privat në qytet. Edhe pse stafi i bashkisë kishte bërë të gjitha përpjekjet në këtë projekt, përfaqësimi nuk ishte në nivelin e duhur. Ndaj, vizitorët që vizitonin standin e Bashkisë së Korçës nuk shfaqën ndonjë interes në këtë projekt.

Me mbështetjen e Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore në Shqipëri (LGPA), Bashkia e Korçës kishte mundësinë të bënte një prezantim dinjtoz në panairin e 6-8 tetorit 2008, i cili rriti mundësitë për financime.

LGPA financoi një studim urbanistik për rinovimin dhe zgjerimin e kompleksit sportiv të qytetit, që është edhe i vetmi i kësaj madhësie në vend, kompleks që u ndërtua gjatë periudhës 1975-1980, por që aktualisht është jashtë funksionit. Bashkia do të marrë pronësinë e kompleksit sportiv nga qeveria qendrore si rezultat i procesit të transferimit të pronave që aktualisht është në proces e sipër. Propozimi për të rigjallëruar këtë kompleks dhe për ta sjellë atë në nivele moderne erdhi nga Bashkia e Korçës në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Sporteve. Nisma është në përputhje me vizionin afatgjatë të bashkisë për ta bërë Korçën në qendër të rëndësishme urbane të Shqipërisë juglindore. Në materialet promovuese të përgatitura me mbështetje nga Projekti LGPA përfshiheshin një raport fillestar financiar i realizueshmërisë si dhe një tur 3-dimensional elektronik i kompleksit sportiv.

Sofjola Kotelli, specialiste në Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik në Bashkinë e Korçës, tha se ndryshe nga Panairi i 2007, EXPO-REAL i vitit 2008 u vizitua nga 40 vizitorë, nga të cilët të paktën 10 prej tyre treguan më shumë interes për të njohur hollësitë e projektit. Vizitorët dhanë edhe opinionet e tyre në lidhje me përmirësimin e studimit të fizibilitetit si dhe për planin e biznesit duke synuar rritjen e mundësive të financimit për vitin 2009.

Ideja e të mësuarit duke punuar dhe ndjenja e optimizmit që morëm nga vizitorët që treguan interes në projektin tonë, tha z. Sotiraq Filo, Zv. Kryetar i Bashkisë së Korçës, i bënë drejtuesit e pushtetit vendor të mendojnë për mënyrat e përmirësimit të prezantimit të tyre në panairin e vitit 2009. Si rrjedhojë e kësaj, stafi i bashkisë vendosi një strategji të re komunikimi për investitorët e mundshëm të panairit 2009, duke iu dërguar atyre paraprakisht katalogun me projektin e përmirësuar. Përveç kësaj, duke marrë parasysh rëndësinë e madhe të Panairit EXPO-REAL, Bashkia e Korçës vendosi të rrisë buxhetin e saj në 4,000 Euro për vitin 2009, shumë që do të përdoret për të promovuar këtë projekt në panairin e ardhshëm.